



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-119
Prishtinë, më 21 shtator 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 21 SHTATOR 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Nexhat Daci, Ibrahim Gashi, Slllobodan Petroviq dhe Numan Baliq, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ismet Beqiri, Ibrahim Makolli, Ardian Gjini, Lulzim Zeneli, Branislav Gërbiq dhe Xhezair Murati.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skënder Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga Zyra e Presidentit: Lumnije Murati,
Nga ZCN: Blerta Bejtullahu
Nga OSBE: Floriana Shala, dhe
Nga NDI: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, mbajtur më 14 shtator 2010,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 14 shtator 2010

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 14 shtator 2010, u miratuar pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë, veç e veç, dhe me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare vendosi që mbledhja e radhës e Kuvendit të mbahet më 23 shtator 2010, me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimet e sigurisë private,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Ekonomiko-Social,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 204/33 për blegtorinë e Kosovës,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis,
11. Shqyrtimi i Propozim-strategjisë së sigurisë të Republikës së Kosovës,
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave,
13. Shqyrtimi i Rekomandimit lidhur me nominimet për Bordin për Ankesa të Mediave nga Gjykata Supreme e Kosovës.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Shqyrtimi i propozimit të Komisionit për përzgjedhjen e anëtarit dhe të kryesuesit të Bordit Drejtues të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimin e Komisionit për përzgjedhjen e anëtarit dhe të kryesuesit të Bordit Drejtues të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Kosovës që, brenda afatit prej 15 ditësh, të japë mendimin e vet lidhur me propozimin e Komisionit për përzgjedhjen e anëtarit dhe të kryesuesit të Bordit Drejtues të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, në pajtim me Ligjin nr. 03/L-084 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/20, për pensionet në Kosovë.

3.2 Shqyrtimi i mocionit të deputetit Riza Smaka për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Kuvendit

Kryesia, pasi shqyrtoi mocionin e deputetit Riza Smaka për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Kuvendit, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Mocioni i deputetit Riza Smaka lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Kuvendit, i dërgohet Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, për procedim të mëtejshëm.

3.3 Shqyrtimi i kërkesës të kryetarit të Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, Hydajet Hyseni-Kaloshi, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Itali

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e kryetarit të Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, Hydajet Hyseni-Kaloshi, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Itali, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i kryetarit të Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, z. Hydajet Hyseni-Kaloshi, për në Itali, prej 21 deri më 24 shtator 2010.

2. Shpenzimet e udhëtimit, të qëndrimit dhe të akomodimit për të lartpërmendurin në paragrafin një (1) të këtij vendimi i bart organizatori, ndërsa mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit, në përputhje me vendimin e Kryesisë së Kuvendit nr. 03-V-094.

Pikat shitesë:

3.4 Procedimi i Projektligjit për Radiotelevizionin e Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Projektligjin për Radiotelevizionin e Kosovës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për Radiotelevizionin e Kosovës i dërgohet Qeverisë së Republikës së Kosovës, për mendim.
2. Njëkohësisht, Projektligji për Radiotelevizionin e Kosovës i dërgohet Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave për verifikimin e Deklaratës për ndikimin buxhetor dhe Ministrisë për Integritet Evropian për hartimin e Deklaratës për përafrim me legjislacionin e BE-së.

3.5 Shqyrtimi i kërkesës të Grupit Joformal të Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës për lejimin e udhëtimit zyrtar në Turqi

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Grupit Joformal të Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës për lejimin e udhëtimit zyrtar në Turqi, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i Grupit Joformal të Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës në Turqi, prej 21 deri më 23 shtator 2010, në përbërje: Flora Brovina, Sanije Aliaj dhe Myfera Shinik.
2. Shpenzimet e udhëtimit, të qëndrimit, të akomodimit, të mëditjeve dhe shpenzimet tjera për të lartpërmendurat në paragrafin një (1) të këtij vendimi përballohen nga buxheti i Kuvendit, në përputhje me vendimin e Kryesisë së Kuvendit nr. 03-V- 094.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen në orën 11:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për çështje plenare dhe procedurale